

di Shënmëria, ku ja shtruam në lëndinë e një kishë të vjetërë. Një malësore na shiti ca bukë pe misri të ngrohë dhe ja thamë qoshet dyke e ngrënë me sardhele dhe me gjalpë. Evrope të kutisë. Burnesha kish edhe djathë për të shitur mirpo e lypse shirenjt dhe kështu s' ja muarm. Dyke hipur në Spaç, rrugës takuam një shtëpi të nderçmë, siç e thosh xhandari, dhe atje e zonj' e shtëpisë, një grua bajmake, na ftoj të pimë nga një kafe. Në këtë vënt blemë edhe një palë çerape të bukura dhe mjaft të lira.

E lamë shtëpinë mirëpritëse, dhe po vinim lart e më lart. Atje ku pandenim se arrimë në Spaç na çfaqeshe edhe një kodrë, më tej edhe një tjetër! Në disa vënde dbora nuk kish shkri-rë, dhe ja nismë një lufte me topa pe dbore. Fillimin e bëri Amërerikani, i cili ish kryelartër për të futurit në Mirditë të këtij zakoni arësimitar në vënt të luftës me plumb!!

Të lodhur e të kapitur, arrimë ndajnatë herë ke kodra e Spaçit, ku dukeshin ca shtëpi të përbashkëta. Xhandari na tregoj një kullë të bardhë dhe na tha se do flinim n' atë vënt. Qe shtëpia e Zef Noçit, burrit me nam të Mirditës.

Arrimë ke kulla e bardhë dhe xhandari foli me të zonjën e shtëpisë për të na pranuar në shtëpin' e saj. "Oshxhelden! Oshxhelden!", na thotë edhe zonja që del nga kulla, dhe e ci-